



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë

www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: Kriminalistika

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Kriminalistika
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	2018/2019 - Viti i II -të, semestri i IV-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6/ECTS
Koha / lokacioni:	Ligjërata: E hënë 09:00-10:45, A33-11:00-12:45 Asistent: Dr. Sc. Fatmire Krasniqi
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc. Feti Limani, Prof. Ass.
Detajet kontaktuese:	fetilimani@hotmail.com
Përshkrimi dhe qëllimi i studimit të lëndës	Kriminalistika paraqet një sistem metodash shkencore, të cilat zbatohen në procesin e përgatitjes dhe të zhvillimit të veprimtarive operative-hetimore dhe gjyqësore drejtë zbulimit, zbardhjes sa më të shpejtë dhe më të plotë të veprave penale dhe kryerësve të tyre, si dhe venjen e të njejtëve para drejtësisë duke ju shqiptuar të njejtëve edhe dënimet e merituara ligjore për veprat e kryera. Qëllimi kryesor i lëndës është që studentëve të Fakultetit Juridik t'iu ofrohen njohuri të përgjithshme mbi zbulimin, hetimin, sqarimin e krimit, drejt parandalimit të tij. Siq dihet studentët që përfundojnë këto studime mund të punësohen në institucione të ndryshme shtetërore të cilat ballafaqohen në mënyra të ndryshme me kriminalitetin, si p.sh., në gjykata, polici, prokurori publike, avokati, Institucione penitenciare (ente për ekzekutimin e sanksioneve penale), etj., andaj njohuritë e fituara nga lënda e Kriminalistikës, atyre mund t'iu shërbejnë në masë të konsiderueshme në punën e tyre të përditshme për pengimin, zbulimin dhe sqarimin e kriminalitetit. Në kuadër të lëndës së Kriminalistikës, studentëve iu ofrohen njohuritë e përgjithshme mbi Kriminalistikën, zanafillën, historikun, metodat dhe objektin e saj shkencor. Përveç këtyre njohurive të përgjithshme, përpunohen edhe dy pjesët e rëndësishme të kriminalistikës dhe atë: Teknika Kriminalistike dhe Metodika Kriminalistike.

	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje: 1. Të përshkruaj dhe pjesërisht të përdorë disa mjete të teknikës kriminalistike që përdoren në fiksimin e gjurmëve të veprave penale në përgjithësi; 2. Të përshkruaj dhe pjesërisht të përdorë metodat shkencore për identifikimin e gjurmëve balistike; 3. Të përshkruaj dhe krahasojë metodat e teknikës së fotografisë që zbatohen në procesin e parandalimit dhe të luftimit të kriminalitetit; 4. Të hartojë tekstin dhe të zbatojë testimin poligrafik të personave të dyshimt për kryerjen e veprës penale si dhe 5. Të zbatojë praktikisht ngacmimin e gjurmëve latente të gishtërinjëve, me metodën e brushës dhe të pluhurave magnetik.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Më të përfunduar të këtij kursi (studimi), kandidati do të jetë në gjendje që më sukses të interpretojë dhe të zbatojë : 1. Format më të mira dhe më të suksesshme të veprimeve operative kriminalistike drejtë hetimit dhe zbulimit të veprave penale dhe kryerësve të tyre; 2. Të zbatojë metodat sa më të përsosura të hetimit dhe zbulimit të krimeve dhe kriminelëve të llojeve dhe kategorive të ndryshme; 3. Që të jetë në gjendje që me sukses të zbatojë ligjin dhe rregullat kriminalistike drejt zbulimit dhe ndriqimit të krimeve dhe kriminelëve si dhe 3. Që të kontribuojë në përkufizimin dhe parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi.

Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2		2
Ushtrime teorike/laboratorike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2		2
Kollokfiume,seminare	1		1
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2		2
Përgatitja përfundimtare për provim	2		2
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1		1
Projektet, seminare, prezantimet ,etj			
Totali	10		10

Metodologjia e mësimdhënies:	1. Metoda e mësimdhënies aktive. Në mbështetje të kësaj metode shpjgohen, përkufizohen nocionet mbi institutet themelore të Taktikës Kriminalistike, si degë e sistemit juridik, interpretimi i drejtë dhe i qartë i tyre, e sidomos duke veçuar rëndësinë e jetësimit të parimeve dhe dispozitave tjera. 2. Metoda e mesimdhënies inter-aktive. Zhvillimi i hovshëm i shoqërisë së sotme, si dhe rritja me ritme marramendëse e informacionit, i ndihmuar nga mjetet e shumëllojshme të transmetimit e komunikimit masiv, kanë bërë të mundur që mësimdhënia dhe mësimnxënia të ndryshojë në mënyrë rapide. 3. Metoda krahasuese ju mundëson studentëve njohjen dhe krahasimin e instituteve më të rëndësishme të taktikës kriminalistike dhe të rregullimit të kësaj fushe hetimore të vendeve fqinje dhe më gjërë. 4. Metoda e analizës. Kjo metodë u mundëson studentëve të kuptuarit më fundamental të instituteve dhe parimeve me të cilat shërbehet taktika kriinalistike dhe atë duke e bërë zbërthimin – analizën përmajtësore të dispozitave në të cilat përkufizohen parimet kryesore dhe institutet themelore të sferës së Taktikës kriminalistikesë me qëllim të aftësimit të studentëve, që pas përfundimit të studimeve të jenë në gjendje të bëjnë zgjidhjen e çështjeve nga fushëveprimtaria e kësaj lëmie jo vetëm në aspektin teorik por edhe në aspektin praktik në gjyqësinë e vendit. 5. Metoda e studimit të rasteve. Rëndësi të veçantë gjatë interpretimit dhe shpjgimit të instituteve themelore të Taktikës kriminalistike, ka edhe studimi i rasteve të veçanta nga praktika gjyqësore lidhur më këtë lëmi.
Metodat e vlerësimit:	Studentët i nënshtrohen vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. Testi gjysmësemestral dhe ai final mbahen me shkrim. Në vlerësimin përfundimtar përfshihet edhe pjesëmarrja aktive në orën mësimore dhe detyrat e shtëpisë. - Testi gjysmësemestral 30% - Testi final 50% - Aktiviteti në orë (seminar, ese, detyre shtëpie, etj)15% - Pjesëmarrja 5% Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50, nuk mbërrijnë/përmbyllin notën kaluese.
Literatura	
Literatura bazë:	Dr. Feti Limani, <i>Kriminalistika</i>, Ligjerata të autorizuara, 2019. Dr. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë periudha 2000-2010</i>, Prishtinë, 2015 dhe

	<i>Kriminalistika</i>, Nezhat Korajlic, Prishtinë, 2009; Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, Vëllimi 1 dhe 2, 2001, <i>Kriminalistika</i>, 2004; Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2014;
Literatura shitesë:	Kodi i Drejtësis për të Mitur i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2010; Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës; Kodi i Procedurës Penale të Kosovës – 2004 dhe Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2004; Kodi Penal i Republikës së Kosovës 2013; Ligjerata të autorizuara të mësimdhënësit. Ligji mbi rendin publik i Kosovës – 2010; Ligji mbi sigurin e trafikut rrugor i Kosovës -2006; Ligji për Ekzektimin e Sanksioneve Penale, Prishtinë, 2004;
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Nocioni, shkenca, njohuritë e përgjithshme Detyrat, objekti dhe metodat e Kriminalistikës Zhvillimi i Kriminalistikës Shkenca e Kriminalistikës dhe luftimi i kriminalitetit Literatura: Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, 2001 dhe 2004 dhe Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Kriminalistika</i>, 2009
Java e dytë:	Parimet dhe sistemi i Kriminalistikës a. Parimi i lirisë teknike-Taktike b. Parimi metodik dhe i planifikimit të procedurës c. Parimi i shqyrtimit kritik të veprimit ç. Parimi shpejtësisë dhe befasisë d. Parimi i themelësisë dhe këmbëngulësisë dh. Parimi i objektivitetit-paanësisë e. Parimi i drejtimit unik të veprimeve operative-taktike për çdo çështje veç e veç ë. Parimi i koordinimit dhe bashkëpunimit f. Parimi i ekonomizimit në të vepruar g. Parimi i diskrecionit (konspiracionit), gj. Parimi i ligjëshmerisë Bashkëpunimi ndërkombëtar kundër kriminalitetit Literatura: Prof. Dr. Skender Begeja, Tiranë, 2004 dhe Dr. Vesel Latifi-<i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2006 dhe 2014

Java e tretë:	Baza shkencore e identifikimit kriminalistik Identifikimi kriminalistik Mjetet për identifikimin kriminalistik Format e identifikimit Antropometria Literatura: Prof. Dr. Skendër Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2001 Vëllimi i parë dhe <i>Kriminalistika</i>, 2004; <i>Kriminalistika-Hyrje në shkencat ligjore</i>, Richard Saferstein, Pearson Edukation, USA, 2014; Criminal investigation, Eighth edition Charles R. Sëanson, Neil C. Chamelin, Leonard Territo, McGraë Hill Companies, USA, 2003; <i>Kriminalistika</i>, Nezhat Korajliq, Prishtinë, 2009; Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2006 dhe Nezhat Korajliq, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2009
Java e katërt:	Teknika kriminalistike-Njohurit e përgjithshme Metodat e teknikës kriminalistike Zhvillimi historik i teknikës kriminalistike Ndarja e teknikës kriminalistike Literatura: Prof. Dr. S. Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004; <i>Kriminalistika-Hyrje në shkencat ligjore</i>, Richard Saferstein, Pearson Edukation, USA, 2014; Prof. Dr. Vesel Latifi, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2006.

Java e tetë:	Ora e parë: Vlerësimi i parë intermediar-lidhur më të arriturat e studentëve që do të përmbajë deri në 20 pyetje nga literatura e shtjelluar në ligjërata gjerë me tani. Ora e dytë: Njoftimi lidhur me (POLIGRAFIN) Literatura: Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2001 dhe 2004; Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001 dhe 2006; Dr. Nezhat Korajliq, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2009 dhe Dr. Sc. Feti Limani, <i>Kriminalistika-Ligjërata të autorizuara</i>, 2019.
Java e nëntë:	Ngritja e versioneve hetimore Baza objektive e versionit hetimor Klasifikimi i versioneve hetimore Metodat logjike të ngritjes së versioneve hetimore- 1. Patrullimi, Vëzhgimi, Prita dhe Racia Literatura: Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004; Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001 dhe 2006; Dr. Nezhat Korajliq, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2009 dhe Dr. Sc. Feti Limani, <i>Kriminalistika-Ligjërata të autorizuara</i>, 2019.
Java e dhjetë:	Taktika e zbulimit të motiveve të veprës penale Llojet e motiveve Rëndësia e shtytjes Motivet e smundjeve psikike Zbulimi i kryerësit të v.p., nëpërmjet motiveve Literatura: Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004. Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001 dhe 2006; Dr. Nezhat Korajliq, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2009 dhe Dr. Sc. Feti Limani, <i>Kriminalistika-Ligjërata të autorizuara</i>, 2015.
Java e njëmbëdhjetë:	Taktika e këqyrjes së vendit të ngjarjes Marrja e masave për ruajtjen e vendit të ngjarjes Masat në vendin e ngjarjes Këqyrja e vendit të ngjarjes Organizimi i këqyrjes së vendit të ngjarjes Radha e këqyrjes së vendit të ngjarjes Këqyrja e plotë e vendit të ngjarjes Këqyrja e viktimës Literatura: Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2004;

	Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001 dhe 2006; Dr. Nezhat Korajliq, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2009; Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik në Kosovë</i>, periudha 2000-2010, Prishtinë, 2015.
Java e dymbëdhjetë:	Metodika kriminalistike Elementet e karakteristike të veprës penale Mënyra e kryerjes së veprës penale Përsonaliteti i fajtorit Motivet dhe qëllimet e veprës penale Motivi dhe qëllimet e kryesit Literatura: Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2001 dhe 2004 Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001 dhe Dr. Sc. Feti Limani, <i>Veprat penale kundër trafikut publik në Kosovë periudha 2000-2010</i>, Prishtinë, 2015.
Java e trembëdhjetë:	Metodika e hetimit të vrasjes Motivi dhe qëllimet e kryerësit Qëllimi i kryesit të krimit-mënyra e kryerjes, rrethanat dhe situatat e tjera Taktika e zbulimit të qëllimit, mënyrës dhe motivit të kryerjes së veprës penale Motivet si shkaktar të kryerjes së krimit (vrasjës) Pyetjet që i drejtohen ekspertit kriminalistik Llojet e vrasjeve (vdekjeve) Veprimet e para hetimore dhe veprimet e tjera Pyetja e të pandehurit si proces hetimor Literatura: Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2001 dhe 2004; Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001; Dr. Nezhat Korajliq, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2009; <i>Kriminalistika-Hyrje në shkencat ligjore</i>, Richard Saferstein, Pearson Edukation, USA, 2014.

Java e katërmbëdhjetë:	Vleresimi i dytë intermediar që do të përmbajë deri në 20 pyetje të shtjelluara në procesin mësimor gjatë këtij semestri: Eksperimenti kriminalistik (Colocuiumi II).
Java e pesëmbëdhjetë:	Metodika e hetimit të krimeve seksuale Veprat penale kundër integritetit seksual –KPRK (n. 228-243) Karakteristikat e krimeve seksuale Karakteristikat e viktimave Veprimet hetimore kriminalistike, Dr. Begeja Versionet hetimore dhe verifikimi i tyre (plani hetimor) Këqyrja dhe ekspertimi Këqyrja e vendit të ngjarjes Pyetja e së dëmtuarës (viktimës) Ekspertimi psikiatrik ligjor Literatura: Prof. Dr. Skender Begeja, <i>Kriminalistika</i>, Tiranë, 2001 dhe 2004; Dr. Vesel Latifi, <i>Taktika kriminalistike</i>, Prishtinë, 2001; Dr. Nezhat Korajliq, <i>Kriminalistika</i>, Prishtinë, 2009; <i>Kriminalistika-Hyrje në shkencat ligjore</i>, Richard Saferstein, Pearson Education, USA, 2014.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
- Fillimi dhe përfundimi i orës mësimore në pajtim me orarin dhe informatën për studentët; - Mos përdorimi i telefonit mobil gjatë ligjëratës; - Mospirja e duhanit; - Moskonsumimi pijeve dhe ushqimeve të ndryshme; - Mos të kopjojnë gjatë provimit dhe testeve të tjera; - Komunikimi civilizues dhe dinjitoz me studentët; - Sigurimi i qetësisë dhe disiplinës gjatë orës së mësimi si dhe - Të dëgjojnë me kujdes si mësimdhënësin ashtu edhe kolegët e tyre.